

FJALA E DEPUTETES ORJOLA PAMPURI

E ENJTE 31 MARS 2022

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë,

Dua ta nis me atë që përfundoi ministrja pak më parë. Dua të ndalem në dy pika. E para ishte përgëzimi që bëri për deputetin, i cili la mandatin. Në fakt, mirë bëni që e përmendni, por, nga ana tjetër, nuk është ndonjë përgëzim i madh, sepse ai deputet dhe ata të tjerët, ai që është kandidat për t'u hetuar, sigurisht për të qenë pjesë e hetimit dhe ai i cili është në burg, që presin të hetohen për shkak të aferës së inceneratorëve, nuk janë i kanë bërë vetëm të gjitha këto afera, sigurisht, fshiheni ju, fshihet kjo qeveri, kjo maxhorancë. Prandaj besoj se përgëzimi nuk ka ndonjë vlerë të madhe, por, sigurisht, ju e përmendni dhe mirë bëni që e përmendni.

Për sa i përket pikës së dytë: "E kemi parë në sy krizën", do t'ju thosha: me cilin sy e keni parë krizën e pandemisë, sepse këtu kemi qenë dhe e keni përmendur disa herë, madje keni kërkuar konsulta konstruktive për sa i përket pandemisë, sigurisht, i keni pasur nga ekspertët e opozitës dhe nuk i keni zbatuar. Sot jemi sërish përballë një krize dhe përsëri theksoni: "Po e shohim në sy krizën". Doja t'ju pyesja sa e keni zbatuar rimbursimin e paketës së medikamenteve, sepse ju i premtuat me shumë vonesë se do t'i rimbursoni medikamentet për personat e prekur nga Covid-i? Edhe atë paketë ne e kemi kundërshtuar, sepse është një paketë, e cila përmban brenda medikamente që ishin shumë të lira në çmim. Nuk ishin ato medikamente që kërkonin vërtet pacientët me Covid. Pra, mënyra se si i përballoni krizat nuk është reale, nuk është e vërtetë, por është thjesht një propagandë, të cilën ua shisnin qytetarëve. Dhe ju mendoni se ju besojnë?! Jo, nuk ju besojnë as për shtesa pensionesh, nuk ju besojnë as për bonuse, nuk ju besojnë për asgjë, sepse realiteti është krejt ndryshe.

Më thoni, zonja Ministre, çfarë mund të bëjë një familje me 3 mijë lekë të rinj në muaj? Asgjë. Çfarë bëni ju me 3 mijë lekë të rinj? Thojani, qartësojani qytetarëve dhe neve këtu se çfarë bëni ju me 3 mijë lekë të rinj! Çfarë mund të bëjë një individ sot me 3 mijë lekë të rinj me çmimet shumë të larta të shportës, me të cilat po përballen qytetarët? Në situatën në të cilën ndodhemi, e gjithë vëmendja jonë sot është te nevoja për t'i mbështetur qytetarët, të kontrolli i plotë ndaj rritjes së pajustificuar të çmimeve dhe mundësimi për këdo i përmbushjes së nevojës bazë: atë të të ushqyerit. Sot ekspertët e ekonomisë ngrenë alarmin që jemi përballë një kaosi, i cili ka zanafillë dhe domosdoshmërisht gjithnjë duhet të justifikohet me faktin që jemi në krizë, sepse po përballen e gjithë bota, jemi në luftë, ka luftë, por nuk është ky justifikimi i vetëm.

Kryefjala e menaxhimit të krizës sigurisht që nuk është kontrolli i tregut nga disa përfaqësues të qeverisë, që enden në disa biznese të vogla apo të mesme apo edhe të mëdha për të treguar se janë aty dhe ju nuk keni ku lëvizni, sepse shkon Kryeministri, shkojnë ministrat në disa biznese dhe i frikësojnë

ato biznese për të mos abuzuar me çmimet. Jo, menaxhimi i krizës përkthehet në ndëshkime reale ndaj abuzuesve, pa dallim, pa klientelizëm, përkthehet në hartim paketash reale sociale, që përkthehen në shërbime dhe ndihmë reale për çdo kategori që përballlet me këtë krizë. Pensionistët, personat me aftësi të kufizuara, familjet që janë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike dhe të gjithë me radhë kanë nevojë imediate për ndihmë, të cilën nuk po e shohin askund gjatë gjithë kësaj periudhe. Gjithashtu, kemi nevojën për kontrolle të vazhdueshme ndaj evazionit në sektorët e karburanteve, sigurisht që ju e trumbetoni herë pas here, por shikoj që nuk është real. Sot jemi përballë një krize tjetër, pas asaj të tërmetit, të pandemisë dhe përsëri vazhdojmë të alokojmë fonde për oligarkët, për projekte dhe koncesione joprioritare.

Është e njëjta situatë, në të cilën ishim edhe në kohën e pandemisë. Sa herë kemi denoncuar tenderë abuzivë, fiktivë, të cilët nuk ishin të nevojshëm? Sa herë kemi thënë që në kohë krizash ka prioritete? Nuk ka arsye pse të alokojmë fonde për koncesionet abuzive edhe në kohë krize, por ju vijoni sërish, pa u shqetësuar aspak. Shqiptarët sot përballen me çmime shumë të larta të produkteve të shportës dhe, përveç vlerës së lartë që po paguajnë për këto produkte, kanë edhe një barrë tjetër mbi supë: po paguajmë më shumë taksa për konsum, siç është përqindja e çmimit të TVSH-së. Ndërkohë, nuk kemi asnjë rritje pagash, asnjë rritje pensioni, përveç indeksimit. Të indeksosh pensionistët, është politika rutinë e çdo viti, dhe me këtë besoj janë dakord të gjithë ekspertët e ekonomisë. Të shesësh si sukses paketën e ndihmës për shtresat në nevojë, e cila logjikisht financohet me rritjen e arkëttimeve nga rritja e çmimit të naftës dhe TVSH-së respektive, ndërkohë që nuk ka asnjë kufizim, siç e përmenda, ndaj koncesionarëve, asnjë masë për kontrollin ndaj abuzimit për fondet publike?! Klientët e qeverisë nuk e njohin krizën, nuk mbajnë asnjë kosto përballë gjithë kësaj krize, ashtu sikurse nuk ka asnjë plan konkret për biznesin, i cili vërtet sot është në vështirësi; e gjitha kjo edhe si rrjedhojë e subvencioneve.

U përmendën në fillim subvencionet në bujqësi. Po sa herë e kemi përmendur në këtë sallë që ka mungesë subvencionesh në bujqësi? Sa nevojë kishim sot që të kishte produkte vendase, kur sot shumica e tokave nga Veriu në Jug janë djerrë pikërisht për shkak të mungesës së këtyre subvencioneve në bujqësi? Këtu te ne taksat nuk përkthehen në shërbime, edhe kur kemi çmime të ulëta energjisë, edhe kur tregjet janë në favorin tonë dhe kjo ndodh, sepse të gjitha këto kërkojnë një mirëmenaxhim, jo të përdoren thjesht si hambarë përfitimi, siç janë përdorur sot nga ju dhe klientët tuaj. Nuk ka nevojë për sjellje populiste, nuk ka nevojë as për propagandë mediatike që t'u mbushim mendjen qytetarëve se ç'po bëni ju si qeveri për ata qytetarë, por për politika reale dhe paketa të rezistencës sociale të vërteta, jo spekulative. Ata sot po përballen çdo ditë me çmime tepër të larta, falë të cilave nuk përmbushin nevojat bazë për mbijetesë.

Shqiptarët tashmë duhet që edhe këtë krizë ta përballojnë të vetëm, siç përballuan tërmetin, siç përballuan pandeminë dhe, realisht, të papërkrahur, ashtu sikurse i kaluan edhe të tjerat, por, të paktën, në krizën e tërmetit dhe të pandemisë nuk kishim këtë tronditje që kemi sot. Sot, ndoshta, edhe ju jeni pak në hall, se duhet të merrni me këtë krizën tjetër të mandatit të deputetit, të aferave të inceneratorëve e tjera me radhë. Kështu që jua dimë hallin, ndaj edhe qytetarëve u themi: përballojeni edhe këtë krizë vetë, siç i keni përballuar edhe të tjerat. Faleminderit!